



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725/535727

Rektor i UMIB-it
Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 277/004
Dt 03.03.2017

Në bazë të nenit 48, pika 1.3, të Statutit të Përkohshëm, Senati i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 2.3.2017, mori:

VENDIM

- I. Refuzohet si e pabazë ankesa e Besana Latifi-Shehaj me nr. prot. 79 të datës 23.01.2017, e paraqitur kundër vendimit të Senatit për përzgjedhjen e personelit akademik në bazë të konkursit të shpallur më 31.10.2016 të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini".
- II. Vërtetohet në tërësi vendimi i Senatit me nr. prot. 63/004, i datës 20.01.2017, për përzgjedhjen e kandidatës Albulena Grajçevci në pozitën "Një asistent për grup lëndësh nga lëmi i Psikologjisë", në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini".

Arsyetim

Universiteti i Mitrovicës ka shpallur konkurs për zgjedhjen e një asistent për grup lëndësh nga lëmi i Psikologjisë, në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini".

Pas shpalljes së njoftimit mbi kandidatët e suksesshëm më 20.01.2017, në ueb-faqen zyrtare të UMIB-it, ankimesja Besana Latifi-Shehaj ka paraqitur ankesë me nr. prot. 63/004, të datës 20.01.2017, me të cilin pretendon se i është bërë shkelje nga ana e Senatit, i cili nuk i ka respektuar procedurat për zgjedhjen e personelit, në bazë të propozimit të komisionit recensues (neni 153 i Statutit).

Senati i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 2.3.2017, duke pasur parasysh propozimin e Komisionit për ankesa dhe parashtrësia, konstatoi se propozimi i Komisionit recensues është në kundërshtim të plotë me nenin 159, pika 2 të Statutit të UMIB-it: "Të ketë notën mesatare në studimet bachelor dhe master jo më pak se 8" dhe ankimesja në të dy nivelet e ka notën mesatare më pak se 8. Ndërsa, kandidatja e përzgjedhur e ka notën mesatare në të dy nivelet (bachelor dhe master) mbi 9, dhe, arsyetimi i komisionit recensues se kandidatja është me e vjetër se 30 vjet nuk ka bazë, për arsye se kandidati konsiderohet "jo më i vjetër se 30 vjet" atëherë kur i mbush 31 vjet, pra kandidatja e përzgjedhur i plotëson të gjitha kriteret në bazë të Statutit. Në bazë të kësaj që u tha më sipër, Senati vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, MASHT-it.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Të përmendurës;
3. Fakultetit;
4. Zyrtarit ligjor.



Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Rektor i UMIB-it